	Kodi i dokumentit: PO-ITWB-02		
	POLITIKA E KONFIDENCIALITETIT		
<a href="mailto:kmoco@intertek-wb.com">kmoco@intertek-wb.com</a>	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 1

## Politika mbi Konfidencialitetit.

### 0. Hyrje

Trupa çertifikuese ITWB, do të funksionojë sipas një politike strikte të privatësisë dhe konfidencialitetit. Politika do të zbatohet në të gjitha aspektet e aktiviteteve organizative të Trupës çertifikuese ITWB, duke përfshirë çertifikimin e sigurt dhe ruajtjen e materialeve të aplikimit, garantimin e sigurisë së materialeve të vlerësimit dhe ruajtjen e rezultateve të kandidatëve dhe të dhënat e mbajtësit të aplikimit dhe çertifikimit.

**0.1** Anëtarët e Bordit të **ITWB** -së; personat e çertifikuar dhe ofruesit e shërbimeve të kontraktuara duhet t'i përmbahen përcaktimeve të Politikës së privatësisë dhe konfidencialitetit.

### 1.0 Konfidencialiteti

**1.1** Organizmi çertifikues ITWB, ka hartuar dhe mirëmbanë politikën mbi privatësinë dhe konfidencialitetit, në përputhje me ISO / IEC 17024.


**1.2** Të gjitha informacionet e fituara në procesin e ndjekjes së objektivave të programit të çertifikimit (informacioni konfidencial shtrihet në: informacionet e marra për aplikantët; kandidatët dhe personat e çertifikuar, duke përfshirë informacionin financiar, rezultatet e testit, hetimet, dhe sanksionet)

**1.3** Rezultati negativ për t'u kualifikuar si kandidat/person i çertifikuar; informacionet në lidhje me mirëmbajtjen e çertifikimit dhe ricertifikimi, do të konsiderohen konfidenciale.

**1.4** Personeli i përfshirë në programin e çertifikimit, duhet të mbajnë konfidencial të gjitha informacionet e marra në procesin e çertifikimit. Informacion konfidencial shtrihet për të gjithë informacionin e marrë në lidhje me: aplikantët; kandidatët; personat e certifikuar; pronësia intelektuale dhe administrimin e programit të çertifikimit.

**1.5** Të gjithë personat e përfshirë në procesin e çertifikimit, ose ata që bien në kontakt me informacionin e mbledhur gjatë procesit të çertifikimit do të nënshkruajnë një marrëveshje të detyrueshme ligjore, ku ata sigurojnë se kuptojnë dhe do të veprojnë në përputhje me politikën e konfidencialitetit të përshkruara më sipër. Kjo vlen për punonjësit dhe kontraktorët.

**1.6** Trupa Çetifikuese ITWB, do të sigurojë, që informacioni i marrë gjatë procesit të çertifikimit të personelit nga: aplikuesi; kandidati; personi i çertifikuar, ose nga burime të tjera,

	Kodi i dokumentit: PO-ITWB-02		
	POLITIKA E KONFIDENCIALITETIT		
<a href="mailto:kmoco@intertek-wb.com">kmoco@intertek-wb.com</a>	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 2

nuk i zbulohet palës së paautorizuar pa pëlqimin me shkrim të individit (aplikanti, kandidati ose personi i certifikuar), me përjashtim të rasteve kur ligji kërkon që informacioni i tillë të zbulohet.

**1.7** Menaxhimi i balancës ndërmjet konfidencialitetit dhe dhënies së informacionit, ndikon në besimin e palëve të interesuara dhe në perceptimin e tyre të vlerës në aktivitetet e certifikimit të personelit

1.7 Verifikimi i personelit të certifikuar; emrat e personave të certifikuar dhe statusi i personelit të certifikuar, nuk konsiderohen konfidenciale.

1.8 Statistikat e mbledhura, studimet dhe raportet në lidhje me kandidatët /personat e certifikuar, nuk do të përmbajnë asnjë informacion të identifikueshëm me asnjë kandidat/person i certifikuar, përveç nëse autorizohet me shkrim nga kandidati/ person i certifikuar.


## 2. Marrëveshjet e konfidencialitetit

Aplikantët për certifikimin e personelit duhet të lexojnë dhe të pranojnë një deklaratë konfidencialiteti si pjesë e procesit të aplikimit. Para fillimit të mandatit të tij çdo anëtar i Bordit të Certifikimit do të nënshkruajë një formë konfidencialiteti duke deklaruar se anëtari nuk do të zbulojë ndonjë informacion konfidencial. Anëtarët e Bordit të Certifikimit nuk do të zbulojnë informacionet konfidenciale që lidhen ose diskutohen gjatë takimeve të Bordit të Certifikimit. Kjo përfshinë, çdo informacion verbal, apo të shkruar, që identifikohet si çështje konfidenciale. Të gjithë punonjësve do t'u kërkohej të nënshkruajnë një formular konfidencial para se tu lejohet akses në informacione konfidenciale.

## 3. Trajtimi i informacionit konfidencial

Të gjitha materialet konfidenciale do të identifikohen si informacione konfidenciale dhe do të mbahen në një mënyrë të sigurt siç kërkohej nga politika e sigurisë. Anëtarët e Bordit të Certifikimit, do të mbajnë konfidenciale dhe do të sigurojnë çdo material konfidencial që u dërgohet atyre. Këto materiale do të mbahen në një vend të sigurt dhe privat gjatë gjithë kohës derisa të kthehen në selinë e Shoqërisë ITWB shpk, ose të shkatërrohen sipas udhëzimeve të Drejtorit të Certifikimit.

Punonjësit e Trupës Certifikuese ITWB; anëtarët e Bordit të Certifikimit; anëtarët e komiteve teknike; kontraktorët dhe individë të tjerë të përfshirë në aktivitetet e certifikimit, duhet të ushtrojnë gjykimin dhe kujdesin e duhur gjatë gjithë kohës për të shmangur zbulimin e paautorizuar të informacionit konfidencial. Bisedat në vende publike, siç janë restorantet, ashensorët dhe transporti publik, duhet të kufizohen në çështje që nuk kanë të bëjnë me informacionin e një natyre të ndjeshme ose konfidenciale. Përveç kësaj, këta individë duhet të jenë të ndjeshëm ndaj rrezikut të zbulimit të paqëllimtë dhe duhet të heqin dorë nga informacionet konfidenciale dhe të përmbahen nga përdorimi i altoparlantëve të telefonave, për

	Kodi i dokumentit: PO-ITWB-02		
	POLITIKA E KONFIDENCIALITETIT		
<a href="mailto:kmoco@intertek-wb.com">kmoco@intertek-wb.com</a>	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 3

të diskutuar informacionin konfidencial nëse biseda të cilat mund të dëgjohej nga persona të paautorizuar.

#### **4 Aksesit në informacionet konfidenciale**

Aksesi në informacionet konfidenciale, do të kufizohet tek ata individë, që janë të angazhuar lidhur me programin e certifikimit të personelit. Akesi, do tu jepet, në përputhje me dispozitat e politikës së sigurisë. Punonjësit e Trupës Çertifikuese ITWB, anëtarët e Bordit të Çertifikimit, anëtarët e komitetiteteve, kontraktorët dhe individë të tjerë do të përdorin informacionet konfidenciale vetëm për qëllimin e kryerjes së shërbimeve për Trupën Çertifikuese ITWB

Kjo politikë nuk synon të parandalojë dhënien e informacionit kur dhënia e informacionit kërkohet me ligj.

ITWB PROPER